



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr.20, datë 03.10.2018

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:

**“ZGJERIM I RRJETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE TË OPERATORIT
VODAFON ALBANIA, NËPËRMJET SHTIMIT TË ANTENAVE PËR 4 STACIONE BAZË
TË EMËRTUARA: 1)1243 INSIFA MACRO, 2) PLAZHI I RI, 3)1253 KALIMASH, 4) 1276
HIMARA CNR 2”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Vodafone Albania” sh.a., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Zgjerim i rrjetit të komunikimeve elektronike të Operatorit Vodafone Albania, nëpërmjet shtimit të antenave për 4 stacione bazë të emërtuara: 1)1243 Insifa Macro, 2) Plazhi i Ri, 3)1253 Kalimash, 4) 1276 Himara CNR 2”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Vodafone Albania” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit zhvillues veçmas për secilin prej 4 stacioneve bazë, vetëm pas plotësimit të kushteve të poshtëshënuara:
 - a. Për stacionin “**1243 Insifa Macro**”:
 - konvertimit të zërit kadastral nga “arë”, në “truall” sipas legjislacionit sektorial në fuqi;
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Durrës.
 - b. Për stacionin “**Plazhi i Ri**”:
 - plotësimin e dokumentacionit juridik;
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Vlorë.
 - c. Për stacionin “**1253 Kalimash**”:

- miratimit të procedurave për heqjen nga fondi pyjor/kullosor;
- pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Kukës.


d. Për stacionin “1276 Himara CNR”:

pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Himarë.

4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DAMIAN GJIKNURI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
LEDIA TOTA

